

Master i shkencave

“Master i Shkencave” në “Financë - Kontabilitet”

Titulli akademik i studimit	Diplomë “Master i Shkencave” në “Finance – Kontabilitet”
Cikli i studimit	Studime të ciklit të dytë
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja normale e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Sipas kriterëve

Objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit

Një diplomë në “Master i Shkencave” në Financë-Kontabilitet është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për karriere dhe punësim si dhe siguron njohuritë themelore të kërkuara për të ndjekur një diplomë kërkimore (Ph.D.) në fushat respektive.

Programi i studimit të Ciklit të Dytë në “Master i Shkencave” në Financë-Kontabilitet (me kohë të plotë, 120 ECTS) synon të përgatisë specialistë për:

- a. tregjet dhe institucionet financiare;
- b. realizimin dhe analizën e investimeve publike dhe private;
- c. njohjen dhe implementimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombetare të kontabilitetit; legjisllacionin tatimor dhe tregtar të biznesit;
- d. metodat e kërkimit shkencor në fushën e financës;
- e. auditimin financiar në sektorin privat dhe publik.

Në përfundim të këtij programi, të diplomuarit do të fitojnë këto kompetenca profesionale:

- a. të formulojnë dhe zbatojnë strategji dhe politika për zhvillimin e sektorit financiar;
- b. të kuptojnë, përpunojnë, analizojnë informacionin kontabël dhe financiar, si dhe të marrin vendime që mundësojnë arritjen e zgjidhjeve të suksesshme të biznesit;
- c. të ndertojnë ura bashkëpunimi dhe të kontribuojnë me ide për përmirësimin e politikave financiare, në mënyrë që impakti i tyre tek qytetarët të jetë sa më i madh;
- d. të ofrojnë këshillim dhe asistencë në fushën e kontabilitetit, të shërbimeve të sigurisë, manaxhimit të riskut, auditim, banka tregtare dhe investuese legjisllacionit tatimor, konsulencë ndër të tjera;
- e. të punojnë në fushat e sipërpërmendura në mënyrë individuale ose/dhe në grup, të bashkëpunojnë

në mënyrë etike dhe profesionale me mjedisin e jashtëm, në çdo institucion privat dhe publik, institucione kërkimore-shkencore, institucione shtetërore në nivel qendror dhe local;

- f. të kenë njohuri për përdorimin e sistemeve aktuale të kontabilitetit, duke bërë të mundur integrimin më të shpejtë të tyre në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar;
- g. për planifikimin analitik dhe manaxhimin e projekteve dhe investimeve konkrete.

Plani mësimor sipas veprimtarive formuese
Programi i studimit i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Financë Kontabilitet”

Tipi i Veprimtarisë (A-E)		Lëndët/Modulet	Kredite/ ECTS
A	LËNDË BAZË	Tregjet dhe Institucionet Financiare	6
		E Drejtë Biznesi	6
		Totali	12
B	LËNDË KARAKTERIZUESE	SNK dhe SKK	6
		Analiza e Pasqyrave Financiare	6
		Organizimi i Sistemeve të Kontabilitetit dhe Kontrollit	6
		Auditim	6
		Drejtimi Financiar i Avancuar	6
		Analizë Kosto	6
		Kontabiliteti Financiar i Avancuar	6
		Sistemi Tatimor Tregëtar	6
		Analizë Investimesh	6
		Menaxhim Projektsh	6
		Totali	60
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTE GRUESE	Teoria Moderne e Investimeve	6
		Metodat e Kërkimit Shkencor	6
		Lëndë me zgjedhje: 1. Shërbimet e Sigurisë e Konsulencës 2. Vlerësim Pasurie	6
		Totali	18
D	LËNDË PLOTËSUESE	Praktika	12
		Totali	12
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	Mikroteza	18
		Totali	18
Totali			120